



REPUBLIKA E SHQIPERISE

MINISTRIA E PUNEVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT

MINISTRI

URDHER

Nr. 75, Date 18.5.2010


PER

MIRATIMIN DHE ZBATIMIN E RREGULLAVE E PROCEDURAVE STANDARTE QE IMPLEMENTOJNE RREGULLORET E BE PER PA - RREZIKSHMERINE NE FLUTURIM NE FUSHEN E AVIACIONIT CIVIL

Ne mbështetje te pikës 4, te Nenit 102 te Kushtetutës se Republikës se Shqipërisë dhe Ligjit 10040, date 22.12.2008 “Kodi Ajror i Republikës se Shqipërisë” dhe Ligjin nr. 9658, datë 18.12.2006 “Për ratifikimin e marrëveshjes shumëpalëshe ndërmjet Komunitetit Europian dhe shteteve anëtare të tij, të Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Maqedonisë, Republikës së Islandës, Republikës së Malit të Zi, Mbretërisë së Norvegjisë, Rumanisë, Republikës së Serbisë dhe misionit administrativ të përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, “Për krijimin e një zone të përbashkët të Aviacionit Europian”,

URDHEROJ:

1. Miratimin dhe zbatimin e Procedurave Standarte qe implementojne rregulloret e Bashkimit Europian për Sigurinë Ajrore ne fushat e Operacioneve, Vlefshmërisë Ajrore, vazhdueshmërisë se saj si dhe ne atë te licencimit te personelit fluturues dhe teknik.
2. Ky urdhër ka fuqi dhe shfuqizon te gjitha urdhrat dhe udhëzimet e mëparshme te Ministrit te Punëve Publike dhe Transportit qe trajtojnë ndryshe te njëjtat çështje qe trajtojnë dispozitat e këtij urdhri.
3. Ngarkohet Autoriteti i Aviacionit Civil te RSH për zbatimin e këtij urdhri dhe procedurave qe ai përmban.
4. Ky urdhër hyn ne fuqi ne datën 01/06/2010.


Sokol OLLDASHI
MINISTER

